

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë* (PKEK)

PYETËSOR

**për përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare
në luftimin e korrupsionit**

CIKLI 1

ECU/PECK-5/2012

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

1.	Të përgjithshme.....	4
1.1	Informacion i përgjithshëm për Kosovën	4
2.	Mekanizmat themelorë mbrojtës dhe parandalimi i korrupsionit	5
2.1	Ndarja e pushteteve	5
2.2	Gjyqësori – gjyqtarët / prokurorët	5
2.3	Policia.....	8
2.4	Administrata publike	9
2.5	Deputetët	13
2.6	Financimi i partive politike dhe i fushatave zgjedhore.....	14
2.7	Prokurimi publik.....	17
3.	Ligji penal, zbatimi i ligjit dhe procedura penale	18
3.1	Veprat penale dhe sanksionet	18
3.2	Hetimi dhe procedura penale	22
3.3	Konfiskimi dhe ndalimet e tjera të instrumenteve dhe produkteve të krimit.....	24
3.4	Imunitetet nga hetimi, ndjekja penale apo gjykimi i veprave të korrupsionit.....	26
4.	Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	26

SHËNIM PËR AUTORITETET:

- Autoritetet duhet të japin përgjigje të plota dhe të hollësishme për çdo pyetje më poshtë, dhe të shpjegojnë në një masë sa më të plotë që të jetë e mundur kuadrin ligjor dhe institucional dhe/ose masat e tjera që kanë marrë për plotësimin e çdo kriteri të standardeve ndërkombëtare.
- Në mbështetje të përgjigjeve ndaj pyetësorit të mëposhtëm, autoritetet duhet të ofrojnë kopje të legjislacionit dhe dokumente të tjera, të cilat janë përmendur dhe/ose referuar në përgjigjet ndaj pyetjeve.
- Statistikat e kërkuara duhet të ofrohen (nëse ekzistojnë) në formën e një tabele, të ndara sipas viteve për një periudhë 3-vjeçare.
- Gjatë përgjigjes së pyetjeve që kanë të bëjnë me burimet e agjencisë, ju lutem jepni informacion të hollësishëm për buxhetin, punonjësit, strukturën, si dhe për vlerësimin gjithëpërfshirës të mjaftueshmërisë së burimeve të ndara.

1. Të përgjithshme

1.1 Informacion i përgjithshëm për Kosovën

1.1.1 Ju lutem përshkruani tiparet karakteristike të fenomenit të korrupsionit në juridiksionin tuaj, duke përcaktuar ndër të tjera shtrirjen e tij, format më të zakonshme dhe funksionet e personave të përfshirë. Përshkruani në veçanti përhapjen/shtrirjen e perceptuar të korrupsionit në: a) legjislativ; b) gjyqësor; c) polici; d) administratë publike dhe në e) rrethanat politike si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë vendor.¹

1.1.2 A ka arsye për të besuar se ekziston një lidhje ndërmjet korrupsionit dhe krimit të organizuar në juridiksionin tuaj në Kosovë? Nëse po, ju lutem përshkruani këtë lidhje.

1.1.3 Ju lutem përshkruani se si mediet raportojnë për çështjet e lidhura me korrupsionin në Kosovë.

1.1.4 Ju lutem përshkruani politikën e institucionit tuaj lidhur me mekanizmat ekzistues për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, duke treguar përbërësit kryesorë të kësaj politike dhe përparësitë e përcaktuara brenda kuadrit të saj dhe të planit të veprimit.

1.1.5 Nëse ka institucion (ose institucione) përgjegjës(e) për strategjitë dhe/ose planet e veprimit kundër korrupsionit, ju lutem përshkruani përbërjen e tij dhe kompetencat e funksionet, si dhe efektshmërinë e tij në praktikë. Ju lutem jepni shembuj të veprimeve të ndërmarra.

1.1.6 Ju lutem përshkruani nismat e shoqërisë civile (përfshirë organizatat joqeveritare) për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, dhe nëse këto janë të lidhura me veprimtaritë e autoriteteve, politikat, mekanizmat, etj. Po ashtu, nëse ato janë të lidhura, përshkruani si është e rregulluar kjo lidhje. Gjithashtu, përshkruani shkurtimisht aktorët kryesorë ndërkombëtarë që merren me ndihmesën kundër korrupsionit dhe me bashkëpunimin teknik në Kosovë.

¹ Për të qartësuar informacionin e dhënë si përgjigje në këtë pyetje, ju lutem jepni çfarëdo të dhënash statistikore që janë në dispozicion për fushat në fjalë.

2. Mekanizmat themelorë mbrojtës dhe parandalimi i korrupsionit

2.1 Ndarja e pushteteve

Ju lutem përshkruani se si është bërë ndarja ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (përmes Kushtetutës, legjislacionit, mjeteve të tjera).

2.2 Gjyqësori – gjyqtarët / prokurorët

2.2.1 Ju lutem përshkruani shkurtimisht se si është i organizuar sistemi i gjykatave (llojet dhe nivelet e gjykatave).

2.2.2 Ju lutem tregoni nëse shërbimi i prokurorisë është pjesë e degës së gjyqësorit, degës së ekzekutivit apo e të dyjave.

2.2.3 Ju lutem shpjegoni kategoritë e ndryshme të gjyqtarëve, duke treguar:
a) nëse janë të emëruar apo të zgjedhur;
b) nëse vendimet e ndryshme gjyqësore, varësisht prej llojit të tyre, jepen nga kategori apo lloje të caktuara të gjyqtarëve (ju lutem shtjelloni më shumë).

2.2.4 Në cilin dokument është i përfshirë parimi i pavarësisë së gjyqësorit/gjyqtarëve? Ju lutem jepni dispozitën apo dispozitat përkatëse.

2.2.5 Ju lutem tregoni nëse prokuroria është një institucion autonom, çka në fakt do të thotë autonomia në këtë kontekst dhe si garantohet kjo autonomi.

2.2.6 Ju lutem tregoni se cilët individë apo institucione, nëse ka, mund t'u japin udhëzime për rastet individuale gjyqtarëve apo prokurorëve.

2.2.7 Ju lutem tregoni nëse gjyqtarët dhe prokurorët janë të zgjedhur/emëruar për një periudhë të caktuar apo të pacaktuar. Nëse ata janë të zgjedhur/emëruar për një periudhë të caktuar, jepni hollësi të tjera për kohëzgjatjen e mandatit të tyre, nëse është i ripërtërishëm, cilat kriteret dhe procedura përdoren për ripërtëritjen dhe cili autoritet merr vendime të tilla.
2.2.8 Ju lutem tregoni se cilët persona apo ente janë përgjegjëse për: a) emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; b) ngritjen në pozitë të gjyqtarëve dhe prokurorëve; c) lëvizshmërinë (transferimin, qarkullimin, etj.) të gjyqtarëve dhe prokurorëve; d) shkarkimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.
2.2.9 Përshkruani përbërjen e entit/eve të përmendura në pyetjen 2.2.8, procedurat dhe kriteret e tij/tyre për marrjen e vendimeve dhe a është i mundur parashtrimi i ankesave ndaj këtyre vendimeve.
2.2.10 Ju lutem përshkruani procedurat dhe kriteret për kontrollin e ndershmërisë/pronës së kandidatëve për pozicionin e gjyqtarit/prokurorit.
2.2.11 Ju lutem tregoni pagën vjetore bruto të (i) gjyqtarit profesionist në fillim të karrierës së tij/saj dhe (ii) gjyqtarit të gjykatës më të lartë. Ju lutem jepini këto shifra në numra absolutë dhe gjithashtu si përpjesëtim i pagës mesatare në Kosovë. Ju lutem tregoni gjithashtu nëse kjo pagë ndryshon sipas funksionit aktual, vjetërsisë apo vlerësimit periodik.
2.2.12 Ju lutem tregoni pagën vjetore bruto të prokurorit në fillimit të karrierës së tij/saj dhe se si ndryshon paga gjatë karrierës. Ju lutem jepini këto shifra në numra absolutë dhe gjithashtu si përpjesëtimi pagës mesatare në Kosovë. Ju lutem tregoni gjithashtu nëse kjo pagë ndryshon sipas funksionit aktual, vjetërsisë apo vlerësimit periodik.
2.2.13 Ju lutem përshkruani masat ekzistuese për sigurimin e transparencës së procesit gjyqësor.
2.2.14 a) Ju lutem përshkruani përmbajtjen e parimeve apo kodeve etike/të sjelljes që zbatohen për gjyqtarët dhe prokurorët; b) Cilat janë masat ekzistuese për sigurimin e

pajtueshmërisë me këto standarde?
2.2.15 Ju lutem përshkruani: a) cilat lloje të konfliktit të interesit të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të rregulluara; b) mekanizmat ekzistues për parandalimin e konfliktit të interesit dhe c) si zgjidhen ato para se të lindin.
2.2.16 Ju lutem përshkruani se deri në çfarë mase gjyqtarët dhe prokurorët ndalohen dhe/ose kufizohen në bërjen e veprimeve të caktuara, siç janë: a) pranimi i dhuratave; b) mbajtja e posteve jashtë gjyqësorit; c) punësimi në poste/funksione të caktuara ose angazhimi në veprimtari të tjera të paguara apo të papaguara pas ushtrimit të funksioneve gjyqësore/prokuroriale.
2.2.17 a) Deri në çfarë mase gjyqtarët dhe prokurorët janë të detyruar të deklarojnë pasuritë, të hyrat, kreditë, borxhet, dhuratat apo cilindo interes tjetër. b) Ju lutem përshkruani deri në çfarë mase informacioni që duhet të deklarohet kërkohet edhe për familjen apo të afërmit e gjyqtarëve a prokurorëve.
2.2.18 a) Ju lutem shpjegoni mekanizmin për kontrollin e deklaratave të pasurive/të hyrave dhe interesave dhe deri në çfarë mase janë publike këto deklarata apo procedura. b) Ju lutem përshkruani mekanizmat zbatues ekzistues, nivelin e tyre të pavarësisë, metodat e punës dhe sanksionet në dispozicion në rastin e zbulimit të shkeljeve. Po ashtu, jepni statistikën e mundshme për shkeljet e zbuluara dhe sanksionet e vendosura.
2.2.19 Ju lutem përshkruani trajnimet e dhëna për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me etikën, sjelljen e pritshme, parandalimin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesit, si dhe me çështjet e tjera të lidhura. Mundësisht jepni hollësi të tjera për: a) përmbajtjen e tyre (temat e ligjëruara); b) kohëzgjatjen, periudhën kohore kur është mbajtur (nëse është pjesë e trajnimit fillestar apo atij të vazhduar pa shkëputje nga puna) dhe se a përsëritet; c) atë se a është trajnimi i detyrueshëm apo me zgjedhje.

2.3 Policia

(Të zbatohet gjithashtu sipas rastit për agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, si dogana, policia kufitare)

2.3.1 A është policia nën përgjegjësinë e ministrisë së caktuar apo të ndonjë institucioni tjetër? Ju lutem përshkruani shkurtimisht se si është e organizuar policia në Kosovë.
2.3.2 Ju lutem përshkruani kategoritë e ndryshme të punonjësve të policisë dhe tregoni se si ata a) përzgjidhen; b) verifikohen/kontrollohen dhe c) emërohen në pozicione të ndryshme në hierarkinë e policisë. A ka kritere specifike që shkualifikojnë kandidatët? Nëse po, ju lutem përshkruajini ato.
2.3.3 Ju lutem tregoni pagën vjetore bruto të punonjësve të policisë në fillim të karrierës dhe si ajo ndryshon gjatë karrierës. Ju lutem jepini këto shifra në numra absolutë dhe gjithashtu si përpjesëtim i pagës mesatare në Kosovë.
2.3.4 A ekzistojnë dispozita që vendosin një sistem të qarkullimit të rregullt dhe periodik të punonjësve të policisë që konsiderohen si të rrezikuar nga korrupsioni?
2.3.5 Ju lutem tregoni se cilët individë apo institucione, nëse ka, mund t'i japin udhëzime policisë, për cilat lloje çështjesh dhe në çfarë rrethanash. Përkundrejt cilit person apo organ punonjësit e policisë janë përgjegjës dhe u japin llogari lidhur me: a) detyrat e përgjithshme; b) hetimet penale?
2.3.6 a) Ju lutem përshkruani përmbajtjen e parimeve apo kodeve të etikës/sjelljes që zbatohen për punonjësit e policisë; b) Cilat masa ekzistojnë për sigurimin e pajtueshmërisë me këto standarde?
2.3.7 Ju lutem përshkruani: a) cilat lloje të konfliktit të interesit të punonjësve të policisë janë të rregulluara; b) mekanizmat ekzistues për parandalimin e konfliktit të interesit dhe c) si zgjidhen ato paraprakisht para lindjes së tyre.

2.3.8 Ju lutem përshkruani deri në çfarë mase punonjësit e policisë ndalohen dhe/ose kufizohen në kryerjen e disa veprimeve, siç janë: a) pranimi i dhuratave; b) mbajtja e posteve apo punësimi jashtë policisë ose c) angazhimi në veprimtari të tjera me ose pa pagesë.
2.3.9 Deri në çfarë mase punonjësit e policisë dhe të afërmit e tyre janë të detyruar të deklarojnë pasuritë; të hyrat, kreditë, borxhet, dhuratat apo cilado interesa të tjera. Nëse po, ju lutem përshkruani mekanizimin për kontrollin e këtyre deklaratave dhe mekanizmat e mundshëm zbatues, si dhe sanksionet për shkeljet.
2.3.10 A janë punonjësit e policisë të detyruar të raportojnë rastet e korrupsionit që i hasin në kuadër të shërbimit në polici? Ju lutem përshkruani se si trajtohet kjo brenda policisë. Cili person apo organ do të bënte hetime për këtë?
2.3.11 Ju lutem përshkruani sistemin e procedurës disiplinore dhe të sanksioneve në kuadër të policisë. Po ashtu jepni statistikën, nëse ekzistojnë, për këto procedura dhe sanksionet e dhëna, duke përfshirë sipas rastit procedurat penale.
2.3.12 Ju lutem shpjegoni trajnimet e organizuara për punonjësit e policisë lidhur me etikën, sjelljen e pritshme, parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit, si dhe me çështjet e tjera të lidhura. Jepni hollësi për: a) përmbajtjen e tyre (temat e ligjëruara); b) kohëzgjatjen, periudhën kohore kur është mbajtur (nëse është pjesë e trajnimit fillestar apo atij të vazhduar pa shkëputje nga puna) dhe nëse përsëritet; c) atë se a është trajnimi i detyrueshëm apo me zgjedhje.

2.4 Administrata publike

Fusha e përgjithshme e veprimit

2.4.1 Ju lutem tregoni kuadrin ligjor për administratën publike në Kosovë. A përcakton sistemi kushtetues/juridik parime bazë për rregullimin e funksionimit të administratës publike?
2.4.2 Ju lutem tregoni nëse është ndërmarrë ndonjë hap apo masë për thjeshtimin e

procedurave administrative, sipas rastit, me qëllim lehtësimin e qasjes publike në to dhe përdorimin e tyre ose pjesëmarrjen në procedurat përkatëse.

2.4.3 A ekzistojnë organe brenda administratës publike që janë të specializuara në parandalimin e korrupsionit? Si bashkëpunojnë këto organe me agjencitë për zbatimin e ligjit (policinë)?

2.4.4 Si vlerësohet efektshmëria e masave kundër korrupsionit në fushën e administratës publike?

Transparenca në administratën publike

2.4.5 Ju lutem specifikoni mënyrat e garantimit në Kosovë të qasjes për qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në informacionin e mbajtur nga autoritetet publike (përfshirë informacionin për organizimin, funksionimin dhe proceset vendimmarrëse të administratës së saj publike, me kujdes të veçantë në mbrojtjen e jetës private dhe të dhënave personale, lidhur me vendimet dhe aktet ligjore që kanë të bëjnë me qytetarët), si dhe kuadrin ligjor në fuqi. Ju lutem jepni hollësi për: institucionet për të cilat zbatohen dispozitat përkatëse (mbulimi); llojet e informacionit në të cilat qytetarët kanë të drejtë të kenë qasje (përfshirë situatat kur informacioni mund të mos jepet); afatet kohore; sistemin e pagesës nëse ekziston për dhënien e tyre, si dhe procedurat e rregullimit institucional për ankesat kundër vendimeve për kërkimin e informacionit.

2.4.6 Cila është praktika e përgjithshme e autoriteteve publike (niveli shtetëror, i qarkut apo vendor) lidhur me konsultimet publike me rastin e vendimmarrjes? Cilat mekanizma përdoren? Ju lutem jepni hollësi për ata mekanizma në së paku një fushë – për shembull, proceset e konsultimit me rastin e hartimit të ligjeve, procedurat e planifikimit urbanistik apo proceset e tjera të rëndësishme të vendimmarrjes.

Kontrolli i administratës publike

2.4.7 A ekzistojnë sisteme të ankesave kundër vendimeve administrative (kërkesa tek i njëjti autoritet, ankesa tek autoriteti më i lartë, ankesa në gjykatë) dhe, nëse po, si zbatohen ato në nivelet e ndryshme të përshkruara?

2.4.8 Nëse ekziston institucioni i Avokatit të Popullit, cilat janë kompetencat e tij lidhur me parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe të sjelljeve të tjera të keqadministrimit publik?

Rekrutimi dhe karriera

2.4.9 A ekzistojnë procedura specifike për përzgjedhjen dhe për rekrutimin e zyrtarëve publikë për t'u përpjekur dhe siguruar që i) zyrtarët të përzgjidhen në bazë të meritave dhe ii) që ata të verifikohen nga pikëpamja e integritetit/ndershmërisë, p.sh.: duke verifikuar dosjet personale (penale)? A janë këto procedura standarde apo ato përdoren vetëm për funksionet publike që paraqesin rrezik të ndjeshëm ndaj korrupsionit?

2.4.10 Ju lutem tregoni pagën vjetore bruto të një zyrtari publik përfaqësues në fillim të karrierës së tij/saj dhe si ndryshon ajo gjatë karrierës. Ju lutem jepini këto të dhëna në shifra absolute dhe si përpjesëtim të pagës mesatare në Kosovë.

2.4.11 Ju lutem përshkruani trajnimet e organizuara për punonjësit e administratës publike lidhur me etikën, sjelljen e pritshme, parandalimin e korrupsionit. Jepni hollësi të mëtijshme për:

- a) përmbajtjen e tyre (temat e ligjëruara);
- b) kohëzgjatjen, periudhën kohore kur është mbajtur (nëse është pjesë e trajnimit fillestar apo atij të vazhduar pa shkëputje nga puna) dhe nëse përsëritet;
- c) atë se a është trajnimi i detyrueshëm apo me zgjedhje.

2.4.12 A ekzistojnë dispozita që vendosin një sistem qarkullimi të rregullt dhe periodik të punonjësve të punësuar në administratën publike që konsiderohen të rrezikuar nga korrupsioni? Nëse nuk ekziston një sistem i tillë, ju lutem shpjegoni arsyet për një gjë të tillë.

Kodi i sjelljes/etikës

2.4.13 Ju lutem përshkruani përmbajtjen e parimeve apo kodeve etike/të sjelljes që zbatohen për punonjësit e punësuar në administratën publike?

2.4.14 Cilat masa ekzistojnë për të siguruar që standardet zbatohen (nëse është e përshtatshme) në rastet kur janë shkelur? A marrin informacion autoritetet tuaja për shkeljet e kodeve, për sanksionet dhe për veprimet zbatuese? Nëse ekzistojnë, ju lutem jepni statistika.

2.4.15 Cilat masa ekzistojnë për t'u siguruar që zyrtarë publikë të përvetësojnë këto standarde në mënyrë që ato të bëhen rutinë e sjelljes së tyre zyrtare?

Konflikti i interesit

2.4.16 Ju lutem përshkruani a) cilat lloje të konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë janë të rregulluara; b) mekanizmat ekzistues për parandalimin e konfliktit të interesit dhe c) si zgjidhen ato paraprakisht para se të lindin.
2.4.17 Ju lutem përshkruani se deri në çfarë mase zyrtarët publikë ndalohen dhe/ose kufizohen të kryejnë veprime të caktuara, si: a) pranimi i dhuratave; b) mbajtja e posteve jashtë administratës publike; c) hyrja në marrëdhënie kontraktore (drejtpërdrejt apo tërthorazi) me autoritetet në Kosovë. Ju lutem përshkruani rregullat, nëse ka të tilla.
2.4.18 a) Deri në çfarë mase zyrtarët publikë janë të detyruar të deklarojnë pasuritë; të hyrat; kreditë; borxhet; dhuratat apo cilado interesa të tjera. b) Ju lutem përshkruani se deri në çfarë mase informacioni që duhet të deklarohet kërkohej gjithashtu për familjen apo të afërmit e zyrtarit publik.
2.4.19 a) Ju lutem përshkruani mekanizmin për kontrollin e deklarimeve të interesave dhe deri në çfarë mase deklaratat apo procedura janë publike. b) Ju lutem përshkruani mekanizmat ekzistues të zbatimit, nivelin e pavarësisë së tyre, metodat e punës dhe sanksionet që ekzistojnë në rast shkeljesh.

Raportimi i korrupsionit dhe veprimtaritë pasuese

2.4.20 A i nënshtrohen zyrtarët publikë detyrimit të raportimit të sjelljes joetike/korrupsionit të dyshuar/shkeljeve të detyrave apo të kodit të etikës, të cilat mund t'i hasin gjatë zbatimit të detyrave të tyre? Cilat procedura ekzistojnë për rregullimin e raportimeve të tilla? A janë të përcaktuara këto procedura në dispozitat ligjore apo në rregullat e brendshme?
2.4.21 A ekzistojnë masa për mbrojtjen e zyrtarëve publikë që bëjnë raportime të tilla ("informatoreve")? Nëse po, përshkruajini ato me hollësi.

2.4.22 A ka njësi të posaçme, organe të inspektimit apo persona përgjegjës për hetimin e rasteve të korrupsionit të brendshëm në degë të përzgjedhura të administratës publike (për shembull, brenda organeve të zbatimit të ligjit ose institucioneve të tjera)? Nëse po, ju lutem saktësoni organizimin dhe kompetencat e tyre ² .
2.4.23 Ju lutem specifikoni juridiksionin e organeve kompetente lidhur me hetimet disiplinore për sjellje joetike/korrupsion të zyrtarëve publikë, organet/autoritetet ndaj të cilëve ato janë përgjegjëse, faktorët që sigurojnë pavarësinë e tyre në hetim.
2.4.24 Ju lutem përshkruani marrëdhënien ndërmjet procedurave disiplinore dhe penale.
2.4.25 Çfarë trajnimesh të veçanta u ofrohen zyrtarëve të përfshirë në parandalimin, kontrollin, hetimin dhe zbatimin e masave për luftimin e korrupsionit? Cilat mekanizma ekzistojnë për vlerësimin e efektshmërisë së trajnimeve?

2.5 Deputetët

2.5.1 Ju lutem përshkruani shkurtimisht organizimin e sistemit tuaj parlamentar dhe si zgjidhen deputetët e Kuvendit.
2.5.2 Ju lutem tregoni pagën vjetore bruto të deputetëve të Kuvendit. Ju lutem jepini këto shifra në numra absolutë dhe gjithashtu si përpjesëtim të pagës mesatare në Kosovë.
2.5.3 Ju lutem përshkruani masat ekzistuese për të siguruar transparencën e procesit legjislativ – për shembull nëse historiku i votimit të deputetëve është në dispozicion, qasja e qytetarëve në seancat plenare dhe në mbledhjet e komisioneve, etj.

² Entet e përmendura në këtë pyetje janë ato shërbime ose persona që merren me inspektimin e brendshëm dhe me sigurimin e kontrollit ndaj rasteve të korrupsionit që mund të ndodhin brenda autoriteteve të zbatimit të ligjit apo autoriteteve të tjera.

2.5.4 a) Ju lutem përshkruani përmbajtjen e parimeve apo kodeve etike/të sjelljes që zbatohen për deputetët e Kuvendit; b) Cilat janë masat ekzistuese për sigurimin e përputhshmërisë me këto standarde?
2.5.5 Ju lutem shpjegoni a) cilat lloje të interesave të jashtme apo konflikteve të interesave të deputetëve të Kuvendit janë të rregulluara; b) mekanizmat ekzistues për parandalimin e konfliktit të interesit dhe c) si zgjidhen ato paraprakisht para se të shfaqen.
2.5.6 Ju lutem përshkruani se deri në çfarë niveli deputetët e Kuvendit ndalohen dhe/ose kufizohen nga kryerja e veprimeve të caktuara si: a) pranimi i dhuratave; b) mbajtja e posteve jashtë Kuvendit; c) hyrja në marrëdhënie kontraktore (drejtpërdrejt apo tërthorazi) me autoritetet publike në Kosovë. Ju lutem jepni rregullat, nëse ka të tilla.
2.5.7 Deri në çfarë mase deputetët e Kuvendit janë të detyruar të deklarojnë pasuritë; të hyrat, kreditë, borxhet; dhuratat apo cilindo interes tjetër; b) Ju lutem përshkruani se deri në çfarë mase informacioni që duhet të deklarohet kërkohej gjithashtu për anëtarët e familjes apo të afërmit e deputetit.
2.5.8 Ju lutem përshkruani mekanizmat për kontrollin e deklarimeve të interesit dhe deri në çfarë mase deklaratat apo procedura janë publike; b) Ju lutem përshkruani mekanizmat ekzistues të zbatimit, nivelin e tyre të pavarësisë, metodat e punës dhe sanksionet në dispozicion lidhur me veprat e konfliktit të interesit.

2.6 Financimi i partive politike dhe i fushatave zgjedhore

E përgjithshme

2.6.1 Ju lutem përshkruani kuadrin ligjor lidhur me elementët e mëposhtëm: a) përkufizimin juridik të partive politike; b) a kanë partitë politike personalitet juridik; c) kushtet për njohjen dhe/ose regjistrimin e partive politike.
2.6.2 Ju lutem jepni: - Numrin e partive politike të njohura dhe/ose të regjistruara në Kosovë; - Listën e partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare;

- Informacion se cilat parti janë të përfaqësuara në Kuvend dhe numrin e tyre të vendeve.
2.6.3 Ju lutem përshkruani rregullat për pjesëmarrje në zgjedhje, dhe nëse ka rregulla të pragu për hyrje në Kuvend (numri minimal i votave, përqindja e votave të fituara, etj.).
2.6.4 Ju lutem tregoni se deri në çfarë mase dhe në çfarë konteksti ka shtrëngime (listë të hollësishme shteruese nëse është e mundur) dhe/apo kufizime në dhënien/pranimin nga partitë politike apo subjektet/kandidatët zgjedhorë të burimeve vijuese të financimit: pagesa e kuotës së anëtarësimit në parti; financimi publik (p.sh. monetar, subvencionet, përjashtimet tatimore, shfrytëzimi pa pagesë apo me ulje çmimi i shërbimeve); kontributet nga entet e lidhura me partinë; kontributet nga/për përfaqësuesit e zgjedhur; dhurimet me para në dorë dhe në natyrë; të hyrat nga prona; kreditë, të hyrat nga biznesi apo veprimtaritë e partisë; veprimtaritë e grumbullimit të fondeve, biznesi privat; individët; burime të tjera, ju lutem saktësoni.
2.6.5 Në rast se jepet financimi i drejtpërdrejt apo i tërthortë publik, ju lutem shpjegoni se kush mund të pranojë fondet publike; kushtet që duhet të plotësohen për marrjen e fondeve publike; bazën dhe metodën e ndarjes së tyre; format e ndryshme të financimit të tërthortë ³ , përfshirë kufizimet në këtë financim.
2.6.6 Në rast se lejohet financimi privat, ju lutem përshkruani se deri në çfarë mase, në qoftë se në të gjitha, ky financim mund të bëhet edhe nga kontribuesit anonimë; kontributet nga entet korporative dhe nga kompanitë publike; kontributet nga ente që ofrojnë apo kërkojnë të ofrojnë mallra ose shërbime për administratën publike; kontributet nga personat/entet e huaja; kontributet nga organizatat jofitimprurëse, siç janë organizatat e punëtorëve apo të punëdhënësve, institucionet fetare, organizatat politike, etj; burimet e tjera (p.sh. trashëgimitë, trustet).
2.6.7 Lidhur me shpenzimet e tyre, ju lutem specifikoni çfarëdo shtrëngimesh apo kufizimesh sasiore apo cilësore në sistemin tuaj lidhur me a) partitë politike, b) kandidatët për zgjedhje c) të tjerët?

³ “Financimi i tërthortë” mund të përfshijë, për shembull, format e ndryshme të subvencioneve të brendshme, si koha e lirë në televizionin publik, përdorimi i godinave etj.

Transparenca

2.6.8 Ju lutem përshkruani rregullat dhe praktikat për mbajtjen e librave, regjistrave, llogarive financiare dhe dokumenteve mbështetëse të të hyrave dhe shpenzimeve të a) partive politike b) enteve të lidhura qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, me partitë politike apo që janë nën kontrollin e partisë politike, b) kandidatëve për zgjedhje c) të tjerëve.

2.6.9 Ju lutem përshkruani deri në çfarë shtrirje partitë politike dhe subjektet/kandidatët zgjedhorë detyrohen të paraqesin dokumentet e cekura në pyetjen paraprase tek një organ i jashtëm, të cilit i është besuar mbikëqyrja.

2.6.10 Ju lutem përshkruani se deri në çfarë mase kontributet/dhurimet për partitë politike apo kandidatët në zgjedhje duhet të bëhen publike dhe sa rregullisht, si dhe kush është përgjegjës për botimin e tyre?

Mbikëqyrja

2.6.11 Kontrolli i brendshëm: Ju lutem përshkruani se deri në çfarë mase llogaritë e a) partive politike dhe b) të enteve të lidhura, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me partitë politike u nënshtrohen auditeve të brendshme dhe/apo të pavarura.

2.6.12 Mbikëqyrja e jashtme: Ju lutem përshkruani mekanizmat apo autoritetin ekzistues (nëse ka), të cilit i është besuar monitorimi i respektimit nga partitë politike dhe nga kandidatët i ligjeve për financimin politik dhe i rregulloreve në përgjithësi, si dhe me kontrollin e librave përkatës të kontabilitetit dhe të dokumenteve mbështetëse të këtyre enteve dhe personave.

2.6.13 Ju lutem përshkruani kuadrin ligjor dhe institucional lidhur me këta mekanizma/autoritete të përmendura në pyetjen paraprase, posaçërisht lidhur me pavarësinë dhe llogaridhënien e tyre; financimin; kapacitetin në aspektin e infrastrukturës dhe numrit të punonjësve që janë të paraparë për mbikëqyrjen e financimit politik; përbërjen, emërimet, kualifikimet e punonjësve dhe kohëzgjatjen e mandatit; kompetencat; llojin e institucionit (komision zgjedhor, komision parlamentar, organ kundër korrupsionit, institucion për auditim apo tjetër).

2.6.14 Ju lutem përshkruani procedurat përmes të cilave mund të raportohen shkeljet e dyshuara të rregulloreve për financimin politik, posaçërisht se kush mund t'i bëjë këto raportime dhe kujt. Ju lutem shpjegoni se mbi ç'bazë fillojnë hetimet për shkeljet e dyshuara (ankesat nga qytetarët, kryesisht), dhe cili organ apo organe janë përgjegjëse për këto hetime?

Sanksionet

2.6.15 Cilat sanksione dhe masa (duke marrë parasysh përgjegjësinë administrative, civile dhe penale) janë të parapara dhe për cilat shkelje, në rastet kur enti apo personi është përgjegjës për shkeljen e ligjeve dhe rregulloreve për financimin politik. Ju lutem specifikoni?

2.7 Prokurimi publik

2.7.1 A ka ndërmarrë Kosova hapat e nevojshëm për të themeluar sisteme të duhura prokurimi, bazuar mbi transparencën, konkurrencën dhe kriteret objektive në vendimmarrje, që, ndërmjet te tjerash, janë të efektshme, në parandalimin e korrupsionit.

2.7.2 A i shqyrtojnë këto sisteme:

- (a) Shpërndarjen publike të informacionit në lidhje me procedurat e prokurimit dhe kontratat, përfshirë informacionin mbi ftesat për tender dhe informacionin përkatës ose të rëndësishëm mbi dhënien e kontratave, duke u dhënë kohë të mjaftueshme pjesëmarrësve në tendera të përgatisin dhe të dorëzojnë tenderat e tyre;
- (b) Caktimin paraprak të kushteve për pjesëmarrje, përfshirë kriteret e zgjedhjes dhe të fitimit, rregullat e tenderimit dhe botimin e tyre;
- (c) Përdorimin e kriterëve objektive dhe të paracaktuara për vendimet rreth prokurimit publik, me qëllim që të ndihmohet verifikimi i mëvonshëm i zbatimit të saktë të rregullave apo procedurave;
- (d) Një sistem të efektshëm të rishikimit të brendshëm, përfshirë një sistem të efektshëm ankimi, për të siguruar rekursin ligjor dhe mjetet juridike në rast se rregullat ose procedurat e parashikuara në këtë paragraf nuk respektohen;
- (e) Nëse është e përshtatshme, masat për rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me personelin që është përgjegjës për prokurimin, siç është deklarimi i interesit në prokurime publike të caktuara, procedurat e përzgjedhjes/verifikimit dhe kërkesat për kualifikim?

3. Ligji penal, zbatimi i ligjit dhe procedura penale

3.1 Veprat penale dhe sanksionet

3.1.1 Ju lutem paraqitni një listë dhe përshkruani me hollësi veprat e ndryshme penale sipas së cilave mund të sanksionohet korrupsioni në Kosovë (kryesisht, ryshfeti aktiv dhe pasiv i zyrtarëve publikë vendas dhe të huaj, ryshfeti i anëtarëve të asambleve publike vendase dhe të huaja, ryshfeti aktiv dhe pasiv në sektorin privat, ryshfeti aktiv e pasiv i zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare, ryshfeti aktiv e pasiv i anëtarëve të asambleve parlamentare ndërkombëtare, ryshfeti i gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare, ryshfeti aktiv e pasiv i arbitrave dhe anëtarëve të jurive vendas dhe të huaj, dhe ushtrimi i ndikimit aktiv e pasiv). Ju lutem që për secilën prej këtyre veprave, të specifikoni natyrën dhe nivelin e sanksioneve të parashikuara dhe rregullat për parashkrimin. Ju lutem që të jepni gjithashtu tekstin e dispozitave juridike përkatëse.
3.1.2 Kur korrupsioni kryhet në mënyrë të organizuar (për shembull, në mënyrë sistematike dhe afatgjatë, në veçanti si rezultat i komplotit apo përmes ndonjë rrjeti), ju lutem shpjegoni nëse kjo konsiderohet si vepër penale e ndarë, si rrethanë rënduese apo trajtohet përmes veprave të tjera?
3.1.3 A konsiderohet themelimi dhe menaxhimi i organizatave kriminale, dhe pjesëmarrja në to vepër penale në legjislacionin tuaj? A dënohen këto vepra me mënyra të tjera, për shembull përmes komplotit? Ju lutem tregoni kriteret që përdoren për të përcaktuar ekzistencën e ndonjë organizate kriminale (për shembull: vazhdimësia e organizatës, numri i personave të përfshirë, niveli i hierarkisë).
3.1.4 A përbëjnë faktet në vijim vepra penale apo administrative sipas sistemit tuaj juridik: krijimi apo përdorimi i ndonjë fature ose ndonjë dokumenti apo regjistrimi tjetër të kontabilitetit që përmban informacion të rremë apo të paplotë, mosregjistrimi i paligjshëm i ndonjë pagese për qëllime të kryerjes, fshehjes apo mbulimit të veprave të korrupsionit?
3.1.5 A është caktuar pastrimi i parave si vepër penale ndryshe nga pranimi i mallrave të vjedhura? Nëse po, ju lutem përshkruani elementët e kësaj vepre dhe tregoni kryesisht nëse korrupsioni është vepër kryesore që shërben për qëllime të pastrimit të parave.
3.1.6 a) A janë konceptet e mëposhtme të përdorura në lidhje me korrupsionin aktiv dhe pasiv: (1) zyrtar publik (vendas);

- (2) (anëtarë të) një asambleje publike vendase;
- (3) zyrtar publik i huaj;
- (4) (anëtarë të) një asambleje publike të huaj;
- (5) zyrtar i një organizate ndërkombëtare;
- (6) (anëtarë të) një asambleje parlamentare ndërkombëtare;
- (7) mbajtës të një funksioni gjyqësor ose zyrtar të ndonjë gjykate ndërkombëtare (juridiksioni i së cilës është pranuar nga pala);
- (8) arbitër vendas/arbitër që ushtron funksionet e tij/saj sipas ligjit të brendshëm për arbitrazhin;
- (9) arbitër i huaj/arbitër që ushtron funksionet e tij/saj sipas ligjit të brendshëm për arbitrazhin të çdo shteti tjetër;
- (10) anëtar i një jurie vendase / person që ushtron funksionin e një anëtari jurie në sistemin e tij gjyqësor;
- (11) anëtar i një jurie të huaj / çdo person që ushtron funksionin e një anëtari jurie në sistemin gjyqësor të çdo shteti tjetër anëtar?

b) Nëse po, si janë përkufizuar⁴ këto koncepte në lidhje me këto vepra penale? Ju lutem tregoni nëse të gjitha funksionet/kategoritë e personave të përmendur në nenin 1 (a) dhe (b) të Konventës Penale për Korrupsionin (ETS nr. 173) janë mbuluar nga dispozitat tuaja ligjore.

3.1.7 Ju lutem shpjegoni nëse dhe si elementët/konceptet e mëposhtëm janë zbatuar në legjislacionin tuaj në lidhje me korrupsionin aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publikë vendas:

- a) premtimi, ofrimi ose dhënia (*për korrupsionin aktiv*);
- b) kërkimi ose marrja, pranimi i një oferte ose premtimi (*për korrupsionin pasiv*);
- c) çdo përfitim⁵;
- d) drejtpërdrejt ose tërthorazi;
- e) për vetveten ose për çdo njeri tjetër;
- f) për të vepruar ose mos vepruar në ushtrimin e funksioneve të tij/saj.

3.1.8 A është zbatimi i dispozitave të korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publikë vendas në çdo rast i kufizuar nga përdorimi i koncepteve të mëposhtme? Nëse po, ju lutem tregoni nëse dhe si këto koncepte janë të përkufizuara:

- a) (përfitim) i padrejtë⁶;
- b) i kryer me qëllim.

3.1.9 Ju lutem tregoni nëse elementët/konceptet e përmendur në pyetjet 3.1.7 dhe 3.1.8 zbatohen në një mënyrë të ndryshme në lidhje me korrupsionin aktiv dhe pasiv të personave të përmendur në pyetjen 3.1.6.

3.1.10 (a) A është korrupsioni aktiv dhe pasiv në sektorin privat një vepër penale sipas

4 Nëse këto koncepte nuk janë përkufizuar si të tilla në ligj por janë përndryshe të mbuluara ose të qartësuara më tej në (për shembull) raportet shpjeguese të ligjit, ju lutem jepni një përkthim të dispozitave përkatëse të këtyre teksteve.

5 Ju lutem shpjegoni nëse si përfitimet materiale ashtu edhe ato jomateriale mbulohen nga koncepti i “përfitimit” në legjislacionin tuaj.

6 Ju lutem shpjegoni – për shembull – nëse disa përfitime nuk konsiderohen “të padrejta” (për shembull, dhuratat nën një vlerë të caktuar) dhe për pasojë nuk janë shkak për përgjegjësi penale të zyrtarit publik në fjalë.

legjislacionit vendas? Nëse po, ju lutem shpjegoni nëse dhe si koncepti i mëposhtëm zbatohet në legjislacionin tuaj në lidhje me korrupsionin aktiv dhe pasiv në sektorin privat:

- Personat që drejtojnë ose punojnë për, në çdo lloj cilësie, ente të sektorit privat.

(b) Ju lutem tregoni nëse elementët/konceptet e përmendura në pyetjet 3.1.7 dhe 3.1.8 zbatohen në një mënyrë të ndryshme në lidhje me korrupsionin aktiv dhe pasiv në sektorin privat. Nëse po, ju lutem jepni hollësi të mëtejshme.

(c) A është zbatimi i dispozitave të korrupsionit aktiv dhe pasiv në çdo rast i kufizuar nga përdorimi i koncepteve të mëposhtme? Nëse po, ju lutem tregoni nëse dhe si këto koncepte janë të përkufizuara:

i) gjatë veprimtarisë së biznesit;

ii) (Për të vepruar ose mos vepruar) në kundërshtim me detyrat [e tyre⁷].

3.1.11 (a) A është ushtrimi i ndikimit një vepër penale sipas legjislacionit vendas? Nëse po, ju lutem shpjegoni nëse dhe si elementi/koncepti i mëposhtëm zbatohet në legjislacionin tuaj në lidhje me ushtrimin e ndikimit aktiv dhe pasiv. (Ju lutem referojuni gjithashtu dispozitave përkatëse në legjislacionin tuaj):

- Deklaron ose konfirmon se ai/ajo është në gjendje të ushtrojë një ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e [zyrtarëve publikë].

(b) Ju lutem tregoni nëse elementët/konceptet e mëposhtëm të përmendur në pyetjet 3.1.7 dhe 3.1.8 zbatohen në një mënyrë të ndryshme në lidhje me ushtrimin e ndikimit aktiv dhe pasiv. Nëse po, ju lutem jepni hollësi të mëtejshme.

(c) Me qëllim që të zbatohen dispozitat ligjore për ushtrimin e ndikimit a është thelbësore që ndikimi:

i) të jetë ushtruar ose jo?

ii) çon në rezultatin e synuar ose jo?

3.1.12 Brenda mundësive, ju lutem tregoni numrin e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për të gjitha veprat penale të përmendura më lart gjatë tre viteve të fundit.

3.1.13 Ju lutem specifikoni rregullat e zbatueshme për të përcaktuar nëse autoritetet tuaja gjyqësore kanë juridiksion territorial për të gjitha veprat penale të korrupsionit të përmendura më lart (shih pyetjen 3.1.1) kur janë kryer plotësisht ose pjesërisht në territorin tuaj. A e penalizon legjislacioni juaj korrupsionin e kryer jashtë vendit nga qytetarët të cilët janë me origjinë nga juridiksioni juaj apo edhe nga qytetarë të huaj? Nëse po, ju lutem tregoni kriteret që përdoren. A zbatohet “parimi i penalizimit të dyfishtë” për veprat e korrupsionit të kryera jashtë vendit? Nëse po, shpjegoni si.

3.1.14 Ju lutem jepni tekstin e dispozitave përkatëse në legjislacionin tuaj për ndihmën dhe inkurajimin e kryerjes së të gjitha veprave penale të lartpërmendura (shih pyetjen 3.1.1).

⁷ Nga personat që drejtojnë ose punojnë për, në çfarëdo cilësie, entet e sektorit privat.

3.1.15 (a) Cilat mbrojtje⁸ të veçanta janë të zbatueshme në legjislacionin tuaj penal material në lidhje me veprat penale të përmendura në pyetjen 3.1.1? Ju lutem bashkëlidhni legjislacionin përkatës dhe shpjegoni arsyet për ekzistencën e këtyre mbrojtjeve. (b) Cili do të ishte rezultati (për shembull, pushimi i ndjekjes penale ose ulja e dënimit) nëse kjo mbrojtje do të përdorej në mënyrë të suksesshme?

Përgjegjësia e shoqërive

3.1.16 A ka përgjegjësi civile, penale apo administrative në lidhje me personat juridikë për veprat penale, në veçanti për veprat e korrupsionit dhe veprat e lidhura të pastrimit të parave?

3.1.17 Ju lutem tregoni se në çfarë kushtesh një person juridik mund të jetë përgjegjës në Kosovë për vepra të korrupsionit, dhe specifikoni nëse këto masa janë të zbatueshme për veprat e (i) ryshfetit aktiv (ii) ushtrimit të ndikimit dhe (iii) pastrimit të parave të kryera për përfitime të personit juridik apo në emër të tij. Në çfarë mase mundet që një person juridik të jetë përgjegjës për veprat e korrupsionit dhe të pastrimit të përfitimeve të korrupsionit të kryera jashtë vendit?

3.1.18 Ju lutem tregoni nëse regjimi i përgjegjësisë është gjithashtu i zbatueshëm kur mungesa e mbikëqyrjes apo e kontrollit nga ana e personit fizik, i cili ka pozicion drejtues tek ndonjë person juridik, ka lehtësuar kryerjen e veprave të përmendura në pyetjen e mëparshme.

3.1.19 A është e mundur t'i caktohet përgjegjësia personit juridik kur asnjë person fizik nuk është dënuar apo identifikuar?

3.1.20 A e përjashton përgjegjësia e personave juridikë procedurën penale kundër personave fizikë që janë autorë, nxitës, apo ndihmës të (i) ryshfetit aktiv, (ii) ushtrimit të ndikimit dhe (iii) pastrimit të parave?

⁸ Për shembull, a ka ndonjë dispozitë në legjislacionin tuaj penal material që përjashton një individ nga përgjegjësia penale nëse ai/ajo ka rënë dakord për kërkimin e një ryshfeti nga një zyrtar publik por e raporton atë tek autoritetet përkatëse, a ka ndonjë dispozitë që e përjashton dhënësin e ryshfetit për një zyrtar publik të huaj nga përgjegjësia penale nëse përfitimi është i ligjshëm në vendin e zyrtarit publik të huaj, ose nëse ryshfeti është dhënë nën efektin e kërcënimit?

3.1.21 Ju lutem ofroni statistika apo shembuj të procedurave të ngritura kundër personave juridikë për vepra të korrupsionit.

3.1.22 Çfarë sanksionesh apo masash janë parashikuar në rast se personi juridik është përgjegjës për a) ryshfet, b) ushtrim të ndikimit dhe c) pastrim të parave?

3.1.23 Ju lutem përshkruani nëse ka të dhëna të shoqërive që janë shpallur përgjegjëse për akte të korrupsionit?

3.1.24 A është e mundur të shkualifikohen personat e shpallur fajtorë për vepra penale nga mbajtja e pozicioneve drejtuese në personat juridikë?

Statistikat

3.1.25 Ju lutem jepni statistika rreth hetimeve/ndjekjeve penale/gjyqimit të veprave të korrupsionit gjatë tre viteve të fundit.

3.2 Hetimi dhe procedura penale

3.2.1 Ju lutem përshkruani shkurtimisht organizimin, rolin dhe kompetencat e institucioneve të ndryshme të përfshira në zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit në nivelin qendror dhe të decentralizuar.

3.2.2 A ka departamente, shërbime, njësi të posaçme apo persona në kuadër të policisë, shërbimit të prokurorisë, gjyqësorit apo autoriteteve të tjera në Kosovë (p.sh. shërbime të inteligjencës) të cilëve u janë caktuar funksione specifike dhe/apo kompetenca për parandalimin, kontrollin, hetimin dhe zbatimin e masave për luftimin e korrupsionit? Nëse po, ju lutem tregoni se që kur janë krijuar këto departamente, shërbime, njësi apo persona dhe shpjegoni organizimin dhe kompetencat e tyre.

3.2.3 A është sistemi i drejtësisë penale në Kosovë i mbështetur në parimin e ndjekjes penale

të lirë për të vepruar ose parimit të ndjekjes penale të detyrueshme apo është sistem i kombinuar? Ju lutem shpjegoni sistemin tuaj. Çfarë mekanizmash të kontrollit janë vendosur për të siguruar që ndjekja penale nuk ndërpritet si rezultat i presionit të paligjshëm apo i konsideratave të papërshtatshme? A ka mundësi të tjera (*actio popularis*, veprime nga viktimat, nga tatimpaguesit) që mund të përdoren në raste të korrupsionit?

3.2.4 Ju lutem përshkruani nëse ka rregulla apo procedura specifike ndërdepartamentare ndërmjet policisë dhe shërbimeve të prokurorisë për trajtimin e rasteve të korrupsionit?

3.2.5 A bashkëpunojnë shërbimet e specializuara për luftimin e korrupsionit me ato që luftojnë krimin e organizuar? Nëse po, ju lutem tregoni se si.

3.2.6 Çfarë masash ekzistojnë për të siguruar që personat apo organet përgjegjëse për parandalimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të korrupsionit kanë pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për të kryer funksionet e tyre; veçanërisht për shmangien e presionit të paligjshëm nga eprorët apo nga pushteti politik? A ka mbrojtje për zyrtarët që e raportojnë këtë presion tek eprorët e tyre, policia, prokurori, autoritetet e tjera ose tek publiku?

3.2.7 Ju lutem shpjegoni rregullat e zbatueshme për fshehtësinë e hetimeve (në veçanti, marrëdhëniet ndërmjet hetuesve dhe avokatëve mbrojtës ose avokatëve të palëve që kërkojnë dëmshpërblim në lidhje me qasjen në dosje, zbulimin apo transmetimin e elementeve nga dosja, nevojën për autorizim gjyqësor, sanksionet e zbatueshme; marrëdhëniet midis hetuesve dhe qytetarëve; kufizimet mbi shtypin – p.sh. ndalimi i botimit të dokumenteve të caktuara procedurale që kanë të bëjnë me një rast penal para leximit të tij në një seancë dëgjimore publike)?

3.2.8 Ju lutem tregoni se cilat teknika të veçanta hetimore⁹ mund të përdoren ligjërisht në rastet e korrupsionit. Ju lutem shpjegoni se prej çfarë përbëhen dhe kushtet ligjore që mund të zbatohen për përdorimin e tyre (në veçanti, nëse ato mund të përdoren vetëm për të dyshuarit, nëse ato mund të zbatohen vetëm me miratimin nga gjykata, periudha gjatë së cilës mund të përdoren, etj.).

9 Për shembull, përgjimi në ndërtesa private apo publike; incizimet telefonike; përgjimet e tjera të komunikimeve (posta, faksi, e-mail); vëzhgimet elektronike, vrojtimet, operacionet sekrete, dërgesat e kontrolluara; "pseudo-blerjet " apo "pseudo-veprat e tjera "; informatorët anonimë; bastisjet; ndjekjet ndërkuftare (përfshirë ndjekjet e nxehta); agjentët provokues.

3.2.9 A përbën sekreti bankar pengesë për autoritetet gjyqësore apo të zbatimit të ligjit për mbledhjen e dëshmive? Ju lutem përshkruani dispozitat në fuqi.

3.2.10 A ka masa për mbrojtjen e subjekteve të rrezikuara në kuadër të rasteve të korrupsionit (mbrojtja e viktimave, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, dëshmitarëve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë)? Ju lutem përshkruani se si sigurohet kjo mbrojtje. A bazohet mbrojtja në ndonjë tekst ligjor specifik? Si përkufizohet nocioni i kanosjes? A janë aktet e kanosjes të dënueshme me vepra të ndara juridike? Përmes çfarë veprave të tjera mund të dënohen këto akte? A merren masat mbrojtëse para, gjatë dhe pas procedurave? Çfarë masash mbrojtëse përdoren? A mbrohen edhe individët që janë të lidhur ngushtë apo kanë lidhje familjare me personin që është drejtpërdrejt i lidhur me rastin (viktima, dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë, etj.)?

3.2.11 A mund të përdoren deklaratat e dhëna para autoriteteve ligjore gjatë seancave paraprake dëgjimore si dëshmi në gjykatë nëse është e pamundur prania e dëshmitarit në gjykatë? A mund të regjistrohen dëshmitë e dhëna gjatë seancave dëgjimore paraprake me pajisje audio-vizuale? A është e mundur që dëshmitarët anonimë të japin dëshmi? Ju lutem specifikoni kushtet për pranimin e anonimitetit (për shembull: prania e kërcënimit serioz ndaj dëshmitarit, në mënyrë që të lejohet paraqitja e një dëshmie thelbësore për rastin e gjykatës, dënimi i bazuar jo vetëm në dëshmitë e dhëna nga ai dëshmitar, verifikimi i besueshmërisë së dëshmitarit nga ana e gjyqtarit)?

3.2.12 Çfarë privilegjesh apo marrëveshjesh mund t'i propozohen të dyshuarve apo personave të dënuar, të cilët pajtohen të bashkëpunojnë me policinë dhe gjyqësorin në rastet e korrupsionit (p.sh. negocimi i dënimit, dënimet e ulura, mbrojtja e veçantë)?

3.3 Konfiskimi dhe ndalimet e tjera të instrumenteve dhe produkteve të krimit

3.3.1 Ju lutem përshkruani kuadrin ligjor lidhur me konfiskimin apo format e tjera të ndalimit (duke theksuar nëse konfiskimi i instrumenteve apo të produkteve të korrupsionit është i lirë apo i detyrueshëm); përshkruani se si funksionon kjo në praktikë, duke theksuar kryesisht nëse ka autoritete përgjegjëse për zbatimin e tyre.

3.3.2 Nëse konfiskimi i produkteve dhe instrumenteve të krimit është i mundshëm, a është i mundshëm vetëm për produktet parësore apo edhe për ato dytësore (= të transformuara apo të shndërruara në prona të tjera)? A mund të zbriten shpenzimet për fitimin e produkteve?

3.3.3 A është i mundur konfiskimi i vlerës? Nëse po, si vlerësohet vlera ekonomike?
3.3.4 A është e mundur të konfiskohen produktet e krimit pa siguruar dënimin e autorit të krimit (konfiskimi <i>in rem</i> , i sendit)? Nëse jo, a është duke u paraparë vendosja e këtij sistemi?
3.3.5 Konfiskimi i pronës në zotërim të një pale të tretë: A është e mundur të konfiskohet prona, e blerë nga një palë e tretë apo familjar i afërt (bashkëshort, bashkëjetues, etj.)?
3.3.6 A i parashikon sistemi ekzistues mundësitë për zhvendosjen e barrës së provës për qëllime të konfiskimit të produkteve të korrupsionit? Ju lutem specifikoni.
3.3.7 A i parashikon sistemi ekzistues mundësitë për të përdorur pronën e konfiskuar për përmbushjen e pretendimit të dëmeve nga një person që ka pretenduar dëmshpërblim si rezultat i veprës penale?
3.3.8 Përshkruani shkurtimisht kuadrin ligjor në lidhje me masat e përkohshme (p.sh. masat për ngrirjen apo sekuestrimin e produkteve të krimit, përfshirë veprat e korrupsionit). Ju lutem jepni tekstet ligjore përkatëse.
3.3.9 A ka rregullime specifike për menaxhimin e produkteve të krimit që janë sekuestruar apo ngrirë?
3.3.10 A niset sistematikisht hetimi specifik me qëllim identifikimin, gjurmimin, dhe ngrirjen e produkteve të krimit kur janë zbuluar krime të caktuara të rënda, në veçanti ato të korrupsionit?

3.4 Imunitetet nga hetimi, ndjekja penale apo gjykimi i veprave të korrupsionit

3.4.1 (a) Sipas kushtetutës/ligjit tuaj, a përfitojnë personat e caktuar nga imunitete të veçanta të cilat u lejojnë atyre që të shmangin vënien e tyre nën akuzë për vepra penale që lidhen me korrupsionin?¹⁰

(b) Nëse po, ju lutem saktësoni kategoritë e personave në fjalë dhe shtrirjen e imunitetit të dhënë, si në aspektin e llojeve të veprave penale/kundërvajtjeve të përfshira dhe periudhës gjatë së cilës zgjat imuniteti.

(c) Si dhe kur hiqen këto imunitete dhe cilat kritere përdoren?

3.4.2 (a) A ofron legjislacioni mundësinë për disa persona, në rastet e korrupsionit, që të përfitojnë nga privilegjet e veçanta të cilat u lejojnë atyre të ndiqen penalisht apo të gjykohen në përputhje me një procedurë e cila përbën një përjashtim të ligjit të përgjithshëm?

(b) Nëse po, ju lutem saktësoni kategoritë e personave në fjalë dhe shtrirjen e privilegjeve të dhëna.

(c) Si dhe kur hiqen këto privilegje dhe cilat kritere përdoren?

3.4.3 Ju lutem specifikoni gjithashtu për çdo kategori të personave në fjalë pse është e justifikuar për të mbajtur një imunitet të tillë dhe deri në çfarë mase ky imunitet është zbatuar në praktikë në vitet e fundit.

4. Bashkëpunimi ndërkombëtar

4.1 Ju lutem jepni një listë të detyrimeve shumëpalëshe të bazuara në traktate të cilat kanë të bëjnë me ndihmën ligjore në çështjet penale (përfshirë veprat penale të korrupsionit) të cilat zbatohen në Kosovë apo të atyre që planifikohen të ratifikohen në të ardhmen.

4.2 Nëse nuk ka traktate të zbatueshme apo që të jenë zbatuar, a e parashikon legjislacioni juaj mundësinë për t'u dhënë efekt kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale? A mundëson legjislacioni juaj bërjen e kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale? Ju lutem shpjegoni legjislacionin dhe dispozitat e tjera përkatëse dhe specifikoni veçanërisht kushtet në të cilat juridiksioni juaj do të jetë në gjendje për t'u dhënë efekt kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë.

4.3 Ju lutem tregoni faktorët e veçantë (materialë, ligjorë, politikë apo të tjerë) të cilët

¹⁰ Kjo pyetje nuk ka të bëjë me imunitetin diplomatik.

parandalojnë apo pengojnë ndihmën e ndërsjellë juridike në rastet e korrupsionit.
4.4 Ju lutem jepni statistika të disponueshme për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet e korrupsionit, për pesë vitet e fundit.
4.5 A e lejon juridiksioni juaj ekstradimin e shtetasve në rastet e korrupsionit? Nëse jo, nën cilat kushte autoritetet kompetente në juridiksionin tuaj i ndjekin penalisht ata?
4.6 Ju lutem tregoni cilat konventa dhe traktate ndërkombëtare kundër korrupsionit janë ratifikuar apo planifikohet të ratifikohen në të ardhmen.

Bashkëpunimi i përgjithshëm – asistencë teknike

4.7 Ju lutem përshkruani programet dhe projektet ndërkombëtare kundër korrupsionit, përfshirë ndihmën teknike të ofruar. Tregoni organizatat dhe vendet udhëheqëse të cilët janë përfshirë në këtë proces.
4.8 Ju lutem shpjegoni cilat janë nevojat e ardhshme në aspektin e programeve kundër korrupsionit në Kosovë, përfshirë bashkëpunimin teknik.